

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-091/15

Prishtinë,
2 gusht 2017

Në çështjen juridike të:

I. S.

Klinë

Pala ankuese

Kundër

R. B.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), KPCC/D/C/243/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13264) të datës 18 qershor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 2 gusht 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e I.S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/243/2014 të datës 18 qershor 2014 për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numrin KPA13264.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/243/2014 i datës 18 qershor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA13264.

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale

1. Më 17 gusht 2006, R. B. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur kërkesë në emër të babit të tij të ndjerë, M. B. në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) ku kërkon ri-posedimin e pronës mbi të cilën, siç pretendon, ka humbur posedimin më 25 qershor 1999 për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë konfliktin e viteve 1998-1999. Fillimisht, pala përgjegjëse në ankesë nuk ka dhënë asnjë të dhënë lidhur me pronën të cilën ai e kërkon. Gjatë procedurës ai kishte konfirmuar (faqe nr. 118 të dosjes së lëndës) se kërkesa duhet të procedohet për ngastrën kadastrale nr. 73 me sipërfaqe prej 00.96.48 ha, që ndodhet në fshatin Gjurgjevik, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar).
2. Për të mbështetur kërkesën e tij pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar në AKP:
 - Fletën poseduese nr. 69 të lëshuar nga Departamenti i Zhvendosur i Kadastrit i Klinës e cila e cekë pronën e kërkuar të regjistruar në emër të M. B,
3. Njoftimi i kërkesës ishte bërë më 22 maj 2010 duke e publikuar kërkesën në Gazetën Njoftuese të AKP-së nr. 1 dhe në Buletinin e Zyrës së Pronës së UNHCR-it. Gazeta dhe Lista ishin lënë te kryetari i fshatit i cili pranoi t'i vinte ato në dispozicion për palët e interesuara. Publikimet e njëjta ishin lënë në Komunën e Klinës, Zyrën Kadastrale, Gjykatën Komunale dhe Zyrën Regjionale të AKP-së në Pejë. Gjithashtu, Lista dhe Gazeta ishin shpërndarë në UNHCR, KDR, OSBE, Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ombudsperson dhe EULEX.
4. I. S.(në tekstin e mëtejme: pala ankuese) kishte marrë pjesë në procedurën para AKP-së duke pretenduar se prona e kërkuar faktikisht i takonte familjes së tij por se ajo ishte konfiskuar në vitin 1918 nga regjimi serb.
5. Për të mbështetur kërkesën e tij pala përgjegjëse në ankesë kishte dorëzuar në AKP:
 - Deklaratën e Dëshmitarit, të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Klinës më 31 janar 2007 me numrin 267/2007, ku H. M, B. B. dhe I. Th, që të gjithë në cilësi të

dëshmitarëve, kishin dëshmuar se familja S. nga fshati Pogragjë kishte qenë pronare e pronave të përmendura në fletën poseduese nr. 250, Zona Kadastrale Klinovac dhe fletën poseduese nr. 69, Zona Kadastrale Gjurgjevik. Pronat ishin konfiskuar nga regjimi serb në vitin 1918 ndërsa gjatë viteve 1943-1947 familja S kishte arritur të kthej pronat nën pronësi të saj. Përsëri, në vitin 1948, regjimi serb kishte konfiskuar pronat ndërsa familja S kishte bërë rezistencë, prandaj katër (4) burra të kësaj familjeje ishin vrarë. Deklarata ishte nënshkruar vetëm nga I. Th.

- Fletën poseduese nr. 69 të lëshuar nga Departamenti i Kadastrit i Komunës së Klinës më 1 dhjetor 2007, e cila e paraqet pronën e kërkuar që ceket të jetë në emër të M.B,
 - Propozimin e paraqitur në Gjykatën Komunale të Klinës më 14 shkurt 2014. Sipas këtij propozimi pala ankuese kërkon nga gjykata të vendos masat e përkohshme të sigurisë mbi pronën ndaj palës përgjegjëse në ankesë.
6. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte verifikuar pozitivisht fletën poseduese nr. 69 të dorëzuar nga pala përgjegjëse në ankesë dhe pala ankuese.
 7. Më 18 qershor 2014, KKKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/C/243/2014 vendosi që pala përgjegjëse në ankesë e kishte dëshmuar të drejtën pronësore të M.B. ndaj pronës së kërkuar dhe vendosi të kthej pronën e kërkuar në posedim të palës përgjegjëse në ankesë.
 8. Më 9 mars 2015 vendimi i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë.
 9. Pala ankuese e kishte pranuar vendimin më 20 tetor 2014. Ankesa ishte paraqitur më 14 nëntor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

10. Pala ankuese thekson se vendimi i KKKPK-së përmban shkelje thelbësore të së drejtës materiale dhe procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
11. Pala ankuese pretendon të jetë pronar i pronës së kërkuar që i ishte konfiskuar familjes së tij nga ish-regjimi serb pa asnjë vendim mbi Konfiskimin apo Shpronësimin dhe pa kompensim.
12. Sipas palës ankuese, katër (4) burra të familjes së tij ishin vrarë nga regjimi serb që të parandalonin konfiskimin e pronës dhe dhënien e saj familjes së palës përgjegjëse në ankesë.
13. Pala ankuese me ankesë kishte bashkangjitur provat e njëjta të cilat ishin prezantuar në shkallë të parë.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

14. Gjykata Supreme shqyrtoi vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejshëm: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese gjeti se: *Ankesa është e pranueshme sepse ajo është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 i cili parasheh që pala mund të paraqes ankesë kundër Vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.*

Meritat e ankesës

15. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave në dosje të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
16. Vendimi i KKPK-së është i drejtë. Gjykata nuk ka mundur të gjejë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
17. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të KKPK-së për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e vërteton të drejtën e tij/saj pronësore mbi pronën private por edhe që ai/ajo aktualisht nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat e tilla pronësore mbi pronën përkatëse për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 apo rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt.
18. Gjykata Supreme vëren se pala ankuese, edhe pse ka pretenduar të drejtën ligjore mbi pronën, nuk ka prezantuar asnjë dokument për të mbështetur të drejtën e tij.
19. Vetëm një Deklaratë Dëshmitari në të cilën tre (3) dëshmitarë dëshmojnë se prona i ka takuar familjes së palës ankuese nuk është provë e mjaftueshme për të dëshmuar ndonjë të drejtë pronësore. Për më tepër, deklarata ishte nënshkruar vetëm nga njëri dëshmitar.
20. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk ka gjetur *ex officio* asnjë provë që vinte në pikëpyetje të drejtën e palës përgjegjëse në ankesë në rastin në fjalë.
21. Nga faktet e lartpërmendura rezulton se gjendja faktike në lidhje me këtë çështje ligjore është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se Vendimi i KKPK-së nuk është kundërshtuar me asnjë provë të vlefshme.
22. Nga ajo që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it